

AKT THEMELIMI
I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
“Miria Partners”Sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 07/11/2023, me cilesine e “Ortakut te Vetem Themelues”:

Znj.ERMIRA BENDAJ, atësia Petrit, amësia Merushe, shtetasShqiptar, lindurnëFier, dhebanuesnë TIRANË, me adresërr“Dhimiter Shuteriqi”vila 50, , gjendja civile “Beqare”, madhor, me zotësitëplotëjuridikepërtëvepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 029164471dhe nr. personal J25809073C.

E cila ne respektim te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “, i ndryshuar me ligjin 129/2014, ligjit 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, hartoi aktin e themelimit, te shoqerise me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin “**Miria Partners”Sh.p.k**

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria“**Miria Partners”Sh.p.k**,eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**Miria Partners”Sh.p.k**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka selinë ne njesi tregetare nr 1 me siperfaqe totale 39 m2 me vendodhje rruga” Nexho Konomi ” Unaza e Re Tiranë,Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendimin e ortakut.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëriatregëtare	private	“Miria	Partners”Sh.p.kdo
teushtrojete	gjitahaktivitetete	duke	Shoqeria do
telejearangaligji,		perfshire	



teushtrojetegjthaaktivitetetelejuaralangligji, duke perfshire:

- Objekti i veprimtarive të shoqërisë është: Veprimtari e agentit per transferta parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jo banke.Te gjitha sherbimet e pagesave dhe te transferimit te parave ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jo banke,veprimtari e agentit komisioner etj.
- Te bleje dhe te shese valute ne kartmonedh,leter me vlere,valute nepermjete levizjes se fondeve ne llogari,agjent te transferimit te parave me dhe per llogari te subjekteve te ndryshem jo banke.Ushtrimi i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjekteve te ndryshme financiare jo banke.
- Kryerjen e transakcioneve ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme,kryerjen e veprimtarive dhe /ose pjesmarrjen ne cdo veprim ose aktivitet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperis apo cdo veprimtarine lidhje me to dhe cdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtaris dhe qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacioni Shqiptar.

Ne perputhje me legjislacioni Shqiptar,ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund:

- a) te kryeje cdo aktivitet tregëtar,financiar,dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore;aktivitet keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqeris dhe qe nuk tekalojen ne mase aktivitetet kryesore te cituara me siper,
- b) te kryeje aktivitet publikimi dhe reklamimi,
- c) te kryeje cdo veprimtari perfaqesimi tregëtar ,agjenti tregëtar te komisionerit dhe ndermejtësimit dhe negociatorit ne cdo aktivite tregëtar,

Objekti i veprimtarise te shoqerise mund te ndryshohet, perditesohet, plotesohet ne cdo moment me vendim te ortakut te vetem .

Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj pa afate.Shoqeria munde te shperndahet ne cdo kohe me vendim te Ortakut te Vetem themelues

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(nje qinde mije) lekë.

-Kapitali i shoqerise perbehet nga Nje(1) kuote me vlere nominale sejcila kuot 100.000lek.

-Kapitali themeltare i shoqerise do te paguhet pas regjistrimit te shoqerise ne QKB .



-Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

-Sipas kontributeve të mesiperme Znj. Ermira Bendaj i perket 1 kuote, që i korespondon 100% e kuotave të kapitalit të shoqërisë.

-Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nepermjet emerimit të një eksperti të regjistruar për këto kontribute në natyrë. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIM MARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut të Vetem është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut te Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miratone cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakut te Vetem, vendos per çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10 Administrimi

Administrator i shoqerise eshte **Znj. Ermira Bendaj** , atësia Petrit, amësia Merushe, shtetasShqiptar, lindurnëFier, dhebanuesnë TIRANË, me adresërr“Dhimiter Shuteriqi”vila 50,gjendja civile “ Beqare”, madhore, me zotësitëplotëjuridikepërtëvepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 029164471dhe nr. personal J25809073C.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga vendimi i ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e orakut edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojn ose ekzistojn rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injorinin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i shoqërisë që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të

rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a)kthen ortakut kontributet;

b) paguan ortakut interesa apo dividendë;

c) i shpërndan aktivet shoqërisë;

ç)lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "Miria Partners"Sh.p.k, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakut themelues", ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "Miria Partners"Sh.p.k
ERMIRA BENDAJ**

